

# VESHJA POPULLORE BERATASE PO AQ E FISNIKËVE EVROPIANË

Dr. Petrit **BELLIU**

Akademia “Rrënjët Tona”

## PËRMBLEDHJE

Kumtohet fotoja e kostumit tradicional të djalërisë së Beratit, (mesjeta e mesme e deri sh. XIX, përfshi), sipas një kartoline postale të vitit 1923 dhe një e vitit 1928, ku ka pozuar i njëjti person, përkatësisht 23 dhe 28 vjeçar, me vetëdije origjine të vjetër nga Berati, në një fotostudio në Tiranë. Kopje të vetme, arkivore, që kumtohen për herë të parë.

*Fjalë kyçe: fisnik, djalëri, kumtohen, kartolinë*

## ABSTARCT

The photo of the traditional costume of the boys of Berat is announced, (the Middle Ages until the 19th century, incl.), According to a postal catholic of v. 1923 and one of 1928, where the same person posed, respectively 23 and 28 years old, with awareness of old origin from Berat, in a photo studio in Tirana. Single, archival copies, published for the first time.

*Key words: noble, boyhood, communicated, postcard*

## HYRJE

Duke qenë Berati njëri nga qytetet më të lulëzuar të trevave arbërore, nga autorë të huaj, që e vizituan në kohëra të ndryshme, vihej re edhe një kulturë e spikatur në artin e tij kulinar, si dhe në veshjet femërore e mashkullore. Këtë e vë në dukje edhe udhëtari i famshëm turk, Evlija Çelebi, që e vizitoi qytetin më 1670 dhe 1671. Por ky kumtim i yni substancial përqendrohet vetëm në një dokument të panjohur etnografik : në pamjen fotografike të kostumit tradicional të djalërisë qytetare beratase. Ekzistojnë dy foto të tij, me pozim të njëjtë dhe nga i njëjti individ : njëra e vitit 1923 dhe tjetra e vitit 1928. Ato u ruajtën në arkivin modest të familjes sonë, sepse në to kishte pozuar im atë, i ndjeri Qemal Xhelal Hasanbelliu (1900-1975), kur ishte 23 vjeç dhe pastaj 28.

Një mashkull i ri dhe imponant, fitues në garat sportive lokale e qendrore. Siç dhe shihet në foton e parë, kartolina specifikon: ‘Kostumi Toskënisë’, që asi kohe (vitet 20 të shek. XX), përfaqësohej kryesisht nga Berati. Në të dy rastet përzgjedhja e kostumit pati motivet e veta, siç shpjegonte përsëgjalli pozuesi në to: Kryesore ishte vetëdija e bartur e tij, se origjina e të parëve të tij ishte prej familjes së vjetër beratase të Muzakajve (nga ana mashkullore, dega e konvertuar që herët në islam), dhe Vrahoriti, (nga ana femërore), vendosur, më 1750, (sipas një dokumenti osman që disponojmë), në një çiflik të blerë, në Imësht të Lushnjes. Sa për modesti po aq për neglizhencë, fotoja nuk u publikua ndonjëherë, edhe pse ishte unikale në llojin e vetë



dhe me vlera etnografike. Por kjo nuk i shpëtoi syrit të studjuesit pasionant, Prof. Sazan Gurit, gjatë një vizite në bibliotekën tonë. I ngacmuar fort nga ajo foto e panjohur për të, (duke përfitur edhe nga fakti se e ndjera nëna e tij ishte nga e njëjta derë me personin e fotos, dmth me tim atë), nguli këmbë t'i jepej, për t'u vendosur në kopertinën e librit të tij "*Kush jemi ne shqiptarët*". Detto e fato! (Anipse, në parim, i qe premtuar dikur koleksionistes së shquar beratase, zonjës Parashqevi Sahatçi, për çka i kërkoj ndjesë, me këtë rast).

Pa hyrë në hollësitë përshkruese të kostumit, që do të ishte prerogativë e specialistëve të fushës përkatëse, do të doja të vija në dukje këtu se, nga sa kam pas rastin të pyes, pisqolla, apo koburja në silah (dmth në brezin e armëve), me relief dhe ornamente argjendi, duket t'i përkasë sh. XVIII e në vijim, deri përfund sh. XIX, si armë operative e traditës, që nuk hiqej nga brezi. Prarimi me fije argjendi dhe ari i jelekut dhe mëngoreve të tij, e po ashtu edhe i kallçinjve është i dukshëm. Kurse fustanella dhe krahët e saj të gjerë, nuk kanë nevojë për kurrfarë komenti, si të mirënjohur tashmë. Ndoshta është rasti të vihet në dukje se fustanella mashkullore tradicionale, vazhdoi të mbahej aty-këtu në nahijen e Beratit deri në vitet 30-40 të sh. XX.

Gjatë hulumtimeve të mija, në Tapi të Beratit, në prani të bashkpunëtorëve të mi të ndjerë të Ansambllit Folklorik "Vendi i Shqiponjave", - LLazar Druvari dhe Asqeri Plaku, po nga ai fshat, më treguan se një fare Baro Plaku kishte qenë i fundit në zonën e Urës Hasanbej (Ura Vajguore), që e mbajti fustanellën tradicionale dhe jelekun përkatës deri më 1953. Natyrisht, pa pretendimin e luksit të kostumit të kësaj kartolineje postale, që i takonte djalërisë qytetare të Beratit, kryeqendrës së principatës së dikurëshme të Myzeqesë.



## PËRFUNDIME

1. Ndoshta është rasti të vihet në dukje se fustanella mashkullore tradicionale, vazhdoi të mbahej aty-këtu në nahijen e Beratit deri në vitet 30-40 të sh. XX.
2. Gjatë hulumtimeve të mija, në Tapi të Beratit, në prani të bashkpunëtorëve të mi të ndjerë të Ansambllit Folklorik "Vendi i Shqiponjave".

3. LLazar Druvari dhe Asqeri Plaku, po nga ai fshat, më treguan se një fare Baro Plaku kishte qenë i fundit në zonën e Urës Hasanbej (Ura Vajgurore), që e mbajti fustanellën tradicionale dhe jelekun përkatës deri më 1953.
4. Natyrisht, pa pretendimin e luksit të kostumit të kësaj kartolineje postale, që i takonte djalërisë qytetare të Beratit, kryeqendrës së principatës së dikurëshme të Myzeqesë.